c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

2. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve, përveç rasteve kur për to ka studime të veçanta, nuk duhet t’i kalojë 3–4 katet dhe lartësinë 12.5 (dymbëdhjetë pikë pesë) m deri në kornizën e çatisë.

3. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t’i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

4. Çatitë duhet të jenë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25–30 gradë dhe të mbulohen me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe. Mbulesat e tjera si llamarina, pllaka të ndryshme, si dhe tjegulla me ngjyrë tjetër janë të ndaluara.

5. Rrjeti rrugor ruhet në kompozimin, teknikën dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

6. Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe i shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi-dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale.

7. Lejohen ndërhyrje të mobilimit urban, me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale.

8. Lejohen ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat për funksionim dhe përdorim sa më të mirë të zonës, brenda së cilës rruga ndodhet.

9. Në rastet kur gjurma e rrugës në të cilën ndërhyhet shtrihet në disa zona, ndërhyrja u nënshtrohet kriterëve të zonës me mbrojtje më të lartë.

Neni 8

Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e “Ansambilit arkitektonik urban” dhe zonës mbrojtëse të tij

1. Në hapësirën e “Ansambilit arkitektonik urban” nuk lejohen:

a) instalime që paraqesin rreziqe ose janë të një natyre të rrezikshme, që mund t’u shkaktojnë dëme të rënda ose të pandreqshme njerëzve, pasurive, natyrës dhe peizazhit;

b) depo të të gjitha llojeve;

c) terrene kampingu (për rulo);

ç) terrene sportive (me sipërfaqe mbi 200 m²);

d) struktura industriale;

dh) gurore.

2. Në hapësirën e zonës mbrojtëse të “Ansambilit arkitektonik urban” nuk lejohen:

a) depo të të gjitha llojeve;

b) struktura industriale;

c) guroret.

3. “Ndërtimet pa leje”, të ndodhura brenda territorit të “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj, trajtohen në përputhje me ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Shprehja e autoriteteve të trashëgimisë kulturore është kusht për përfundimin e procedurave të legalizimit për të gjitha rastet e specifikuara shprehimisht në ligj.

Neni 9

Monumentet e kulturës dhe ndërhyrjet e lejuara në to

1. Monumentet e kulturës në “Ansamblin arkitektonik urban” në qytetin e Peshkopisë, sipas vlerave të tyre historiko-kulturore, ndahen në dy kategori:

a) Monumente të kategorisë së parë janë shembujt me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale të Peshkopisë. Monumentet e kategorisë së parë ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Zgjidhja planimetrike dhe funksionale nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së nyjës higjieno-sanitare, kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe si të tilla i nënshtrohen të njëjtit trajtim. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime,



transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese, sipas gjendjes fillestare;

b) Monumente të kategorisë së dytë janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, që marrin pjesë në formulimin kompozicional të qytetit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete. Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së dytë ruajnë volumin fillestar dhe formulimin e pamjes së jashtme. Në brendësi të tyre lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimi i teknikave bashkëkohore. Në raste kur brenda monumenteve të kategorisë së dytë ruhen ambiente karakteristike, si gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale, ose mobilie arkitektonike me vlerë, këto të fundit ruhen dhe i nënshtrohen restaurimit, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.

2. Ndërhyrjet në monumentet e kulturës, të cilat ndodhen brenda “Ansambllit arkitektonik urban” dhe zonës mbrojtëse përreth saj, kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

Neni 10

Objektet pa status, pjesë e “Ansambllit arkitektonik urban”

Objektet pa status, pjesë e “Ansambllit arkitektonik urban”, janë objekte të ndërtuara në vitet ‘50–’90, brenda kësaj zone, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, nuk janë në harmoni me unitetin kompozicional të tij.

Neni 11

Kriteret e projektimit për ndërhyrjet e lejuara në “Ansambllin arkitektonik urban”, monumentet e kulturës dhe zonës mbrojtëse

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të “Ansambllit arkitektonik urban” të zonës mbrojtëse të tij, të cilat përcaktojnë objektet, ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, ritrajtime, rikonstruksione dhe rindërtime, hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim “IKTK”), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (në vijim “DRTK”), përgjegjëse për Peshkopinë, ose persona fizikë apo juridikë, të

licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe shqyrtohen e miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”).

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e objekteve në “Ansambllin arkitektonik urban” dhe në monumentet e kulturës hartohen në varësi të vlerave historiko-kulturore të objektit, si dhe në kriteret për konservim dhe restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim, legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Këto projekte hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë, persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe shqyrtohen e miratohen në KKTKM.

3. Projektet për rikonstruksionin/ rindërtimin/ ritrajtimin/rijetëzimin e objekteve ekzistuese brenda “Ansambllit arkitektonik urban” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, bazuar në studimet urbanistike dhe arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik e teknikën tradicionale, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik;

b) duke respektuar kushtet zhvillimore e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta, me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke respektuar kushtin që lartësia nuk duhet të kalojë lartësinë e dy–tri kateve ose 10.5 (dhjetë pikë pesë) m deri në kornizën e çatisë;

d) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dymëve dhe dritareve, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;

dh) duket ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çative në harmoni me peizazhin kulturor të zonës.



4. Projektet për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja brenda zonës mbrojtëse të “Ansambilit arkitektonik urban” hartohen bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Dibër apo studimeve urbanistike e arkitektonike nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për këtë kategori projektesh.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore, brenda zonës mbrojtëse të “Ansambilit arkitektonik urban”, hartohen:

- a) bazuar parashikimeve të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Dibër;
- b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese në mbrojtje;
- c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Neni 12

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në “Ansamblin arkitektonik urban”, monumentet e kulturës dhe zonës mbrojtëse

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike, të cilat hartohen për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të “Ansambilit arkitektonik urban” dhe të cilat përcaktojnë objektet, ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, ritrajtime, rikonstruksione, rindërtime dhe rehabilitimi hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për Peshkopinë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e rijetëzimin në “Ansambilit arkitektonik urban” dhe në monumentet e kulturës hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse

në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin/ rindërtimin/ ritrajtimin e objekteve ekzistuese brenda “Ansambilit arkitektonik urban” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për rikonstruksionet, ndërhyrje integrale, përshtatjet në sheshe të lira dhe ndërtimet e reja në zonën mbrojtëse të “Ansambilit arkitektonik urban” hartohen nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit dhe ndërtimeve të reja kryhen nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore në zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

6. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimit e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në “Ansamblin arkitektonik urban” hartohen nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë

kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë.

Neni 13

Dispozita të fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.



E	N
536199.6	4616754
536205	4616761
536217.4	4616769
536233.3	4616777
536244	4616780
536256.8	4616783
536263.4	4616784
536273.6	4616785
536277.3	4616785
536294.2	4616790
536300.2	4616792
536305.9	4616769
536297.3	4616759
536282.8	4616748
536277.9	4616738
536275.7	4616728
536275.8	4616719
536268.6	4616699
536251.9	4616682
536248.2	4616678
536231.5	4616684
536213.1	4616686

536128.8	4616678
536093.6	4616672
536080.6	4616669
536002.6	4616649
535985.7	4616648
535988.1	4616652
536000.7	4616655
536033.3	4616671
536048.6	4616685
536062.4	4616697
536095.3	4616720
536109.6	4616732
536129.6	4616754
536136.3	4616756
536148.5	4616757
536158.6	4616756
536184.6	4616754
536192.2	4616752
536199.6	4616754



E	N
535981.6	4616779
535990.6	4616778
536023	4616762
536033.9	4616789
536046.9	4616810
536066.2	4616803
536093.6	4616789
536111.1	4616786
536134.7	4616794
536148.2	4616797
536179.4	4616799
536192.7	4616806
536206.8	4616815
536232	4616831
536255.6	4616845
536270	4616852
536289.2	4616862
536325.2	4616776
536311.9	4616766
536300.2	4616745
536289.5	4616740
536285	4616734
536284.4	4616705
536276.5	4616693
536254.6	4616674
536248.2	4616674
536240.5	4616666
536227.9	4616656
536221.8	4616650
536212.2	4616644
536195.6	4616637
536187.7	4616636
536178.4	4616635
536174.7	4616634
536170.6	4616633
536162.4	4616629
536156.1	4616626
536147.8	4616622
536134.8	4616612
536116.5	4616605
536103.5	4616596
536071.8	4616586
536033.1	4616597
536019.1	4616589
536001.1	4616591
535989.4	4616580
535949.7	4616566
535921.3	4616609
535926.2	4616616
535981.6	4616779

VENDIM**Nr. 146, datë 6.3.2025**

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
SHËRBIMIT TË PROVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ermal Pacaj, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit të Provës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM**Nr. 147, datë 6.3.2025**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2025, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE
SPORTIT, PËR FINANCIMIN E KËSTIT
TË DYTË TË KONTRATËS PËR
REALIZIMIN E TRI TUREVE TË PARA
TË “GIRO D’ITALIA 2025”, NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2025, në zërin “Shpenzime korrente”, në artikullin 605 “Transferta me jashtë”, të programit buxhetor “Zhvillimi i sportit”, i shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh,



për financimin e kështit të dytë të kontratës për realizimin e tri tureve të para të “*Giro d'Italia 2025*”, në Republikën e Shqipërisë.

2. Fondi sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2025, dhe përdoret për kryerjen e pagesës së kështit të dytë, sipas përcaktimeve në kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve, për vitin 2025.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 148, datë 6.3.2025

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 104, DATË 28.2.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR NXËNËSIT NË DIASPORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 49, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 104, datë 28.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënës të diasporës”, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) në fund të pikës 8 shtohen fjalët, me këtë përmbajtje:

“... i cili lëshon vërtetim për mësuesit, që janë pjesë e këtij regjistri.”;

b) pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Për nxënësit që kanë ndjekur programin e mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë lëshohet vërtetim i pjesëmarrjes nga autoritetet që organizojnë mësimin e gjuhës e të kulturës shqiptare në diasporë. Ky vërtetim prodhohet nga Qendra e Botimeve të Diasporës, sipas modelit dhe kërkesave të përcjella nga misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ministrit të përgjegjës për punët e jashtme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 150, datë 6.3.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2025 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri “Transferte në buxhetet familjare” (llogaria ekonomike 606), përdoret për:

a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura, të bimëve mjekësore dhe aromatike e të prodhimeve blegtorale, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave për sipërfaqe të kultivuar dhe për kafshë të matrikulluara;

b) mbështetjen e fermerëve nëpërmjet pagesave për uljen e kostos për naftën që përdoret, për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;

c) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;



ç) mbështetjen e formave të kooperimit në bujqësi.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

2.1. Bujqësia dhe blegtorja

a) Pagesa për gjedh të matrikulluar, në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë lopë/mëshqerrë dhe deri në 5 000 (pesë mijë) lekë/krerë viça për fermer/aplikant, me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë gjedhe.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor (në vijim “SHBB”);

b) Pagesa, në vlerën deri në 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese) për fermer/aplikant, me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi.

Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

c) Mbarështimi i bletarisë, në vlerën deri në 1 000 (një mijë) lekë për zgjua për fermer/aplikant, me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje.

Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”;

ç) Pagesa, në vlerën deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për ha për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Për sipërfaqen mbi 5 (pesë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

Përfitojnë pagesë shtesë fermerët që përdorin kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specat, tranguj, luleshtrydhe).

Masa e përfitimit është në 50% të vlerës totale të faturave tatimore për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se **30 000 mijë lekë për dynym, në rastin e dy mbjelljeve në vit.**

Për fermerët individualë, që aplikojnë për mbështetje vetëm për kontrollin biologjik, sipërfaqja minimale e kultivuar është **3 (tre)**

dynym, ndërsa për aplikantët me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”, sipërfaqja minimale është 1 (një) ha për secilën nga mbjelljet.

d) Pagesa për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike, në vlerën deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/ha për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”;

dh) Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar;

e) Implementimi dhe certifikimi global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

i. por jo më shumë se 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual;

ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur për certifikim në grup, me minimum 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë;

iii. por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) ha në fushë të hapur për certifikim në grup, me minimum 20 (njëzet) fermerë të përfshirë.

2.2. Mbështetje për naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi

2.2.1. Subjektet përfitojnë pagesa në barasvlerë të lehtësimit fiskal për uljen e kostos për naftën, që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kriterëve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2.2.2. Kulturat bujqësore/grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës, për të cilën përlogaritet vlera e përfitimit, janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Çmimi referencë për naftën është çmimi mesatar për muajin dhjetor 2024, i publikuar nga INSTAT-i.



2.2.3. Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. Të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

ii. Sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 1 (një) ha, ndërsa madhësia e parcelave, me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

2.2.4. Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet me vetëdeklarim.

2.2.5. Përfitimi për sipërfaqen që kultivohet është, si më poshtë vijon:

i. Deri në 100% të vlerës për fermerët/aplikantët, me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlogaritjeve të bëra, referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

2.2.6. Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren. Procesi i kontrollit në terren kryhet:

i. për të vlerësuar përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale dhe shmangien e lejuar të faktit të verifikuar të kulturave dhe të sipërfaqes së kultivuar, në raport me vlerën e përfituar, e cila është jo më e madhe se 20%;

ii. në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha.

2.2.7. Çdo subjekt, në rastet kur verifikohet se ka përfituar më shumë se 20% nga vlera për të cilën plotëson kriteret sipas nënndarjes “i”, të pikës 2.2.6, ose ka paraqitur dokumente të pasakta, përjashtohet 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

2.3. Mbështetje për investime në ferma, në zbatim të pikave 2.3 dhe 3/2, të vendimit nr. 130, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për

përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024”, të ndryshuar.

3. Për masat mbështetëse, sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikave 2.1 e 2.2, kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse, vlera e financimit që përfitohet për njësi (krerë, zgjua apo ha), si dhe në total për subjekt, reduktohet në përputhje me këtë fond. Në rastet e shtesave/alokimeve eventuale të fondit, vlera e financimit që përfitohet nuk mund të jetë më e madhe se kufiri për masën përkatëse, i përcaktuar në këtë vendim.

Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim aplikantët me status “Grup fermerësh” dhe “SHBB”, të cilët përfitojnë vlerën maksimale të financimit të parashikuar në këtë vendim, edhe kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse.

4. Për aplikimet në masat mbështetëse, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2.1, kryhet kontrolli në terren për verifikimin faktik të numrit të krerëve, në jo më pak se 30% të subjekteve përfituese.

Çdo subjekt, në rastet kur verifikohet se ka përfituar më shumë se 20% nga vlera për të cilën plotëson kriteret, përjashtohet 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

5. Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët individualë, grupet e fermerëve, personat fizikë e juridikë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



ANEKSI 1

KULTURA BUJQËSORE/GRUP-KULTURAT, NORMATIVAT E KONSUMIT TË NAFTËS DHE VLERA QË PËRFITOHET

Nr./Kodi	Kultura bujqësore/ grup-kulturat	Normativa e konsumit të naftës të punimeve të mekanizuara litra/ha	Vlera që përfitohet lekë/ha	Specifikime
A	Bimë arash			
A.1	Grupi 1	190	18,582	Pranverore (misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum)
A.2	Grupi 2	130	12,714	Të lashta (grurë, tërshërë, thekër, elb), foragjerë njëvjeçarë, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk)
A.3	Grupi 3	90	8,802	Foragjerë shumëvjeçarë, bimë aromatike-mjekësore
B	Drufrutorë			
B.1	Mollë	190	18,582	
B.2	Drufrutorë të tjerë	160	15,648	Të gjitha llojet e frutave, ulli, agrume dhe vreshta
B.3	Arrorë	140	13,692	Arra, bajame, lajthi dhe gështenja (të kultivuara)
B.4	Prodhim i fidanëve frutorë, agrume e arrorë	170	16,626	Për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore dhe arrore
C	Perime			
C.1	Perime fushe sezoni 1	150	14,670	Të gjitha llojet e perimeve, përfshi shalqi, pjepër, luleshtrydhe
C.2	Perime serre, sezoni 1	170	16,626	Të gjitha llojet e perimeve, përfshi shalqi, pjepër, luleshtrydhe

*** Barasvlera e lehtësimit fiskal për litër naftë:**

- Akciza 38.8 lekë/L
- Taksa e qarkullimit 27 lekë/L
- Taksa e karbonit 3 lekë/L
- TVSH (20%) 29 lekë/L¹

TOTAL 97.8 lekë/L

VENDIM

Nr. 152, datë 6.3.2025

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
 BUXHETIN E VITIT 2025, MIRATUAR
 PËR KOMISIONIN QENDROR TË
 ZGJEDHJEVE, PËR ORGANIZIMIN E
 ZGJEDHJEVE PËR KUVEND TË DATËS
 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikave 1 e 3, të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2025, zëri “Shpenzime korrente”, në programin buxhetor 01620 “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”, i shtohet fondi prej 927 212 000 (nëntëqind e njëzet e shtatë milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë) lekësh, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 maj 2025.

2. Efekti financiar i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, miratuar për vitin 2025.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

¹ Çmim referencë për naftën është marrë çmimi mesatar prej 174.1 lekësh/litër me TVSH, i publikuar nga INSTAT-i për muajin dhjetor 2024.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

UDHËZIM

Nr. 44, datë 4.3.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË
BRENDSHËM NR. 93, DATË 27.5.2024,
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
DHE TË DOKUMENTACIONIT QË
PARAQITET PËR APLIKIMIN DHE
PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË
ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË
ZAKONSHME”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 6 dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit të Brendshëm, nr. 93, datë 27.5.2024, “Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit që paraqitet për aplikimin dhe pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike të zakonshme”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

1. Në nenin 1, bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën “a”, togfjalëshi “... pranë drejtorive vendore të Policisë së Shtetit,” zëvendësohet me togfjalëshin “... në zyrat e aplikimit të shoqërisë “IdentiTek” sh.a.”.

b) në shkronjën “b”, fjalia e dytë, zëvendësohet me fjalinë:

“Në raste të veçanta, kur aplikimi nuk mund të kryhet në zyrat e misionëve diplomatike dhe/ose posteve konsullore, njoftohet edhe Ministria e Brendshme.”.

Neni 2

1. Në nenin 4, pas fjalës “... kuponin ...” shtohet

togfjalëshi “... elektronik ose fizik.”.

Neni 3

1. Në nenin 5, pika 2 dhe pika 3, riformulohen dhe ndryshojnë me këtë përmbajtje:

“2. Shtetasit brenda vendit aplikojnë direkt në zyrat e aplikimit, ndërsa për shtetasit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kërkohet rezervimi i takimit për aplikim *online* në portalin *e-Albania*. Për të aplikuar nevojiten dokumentet e mëposhtme:

a) kuponin fizik ose elektronik;

b) pasaporta e fundit;

c) letërnjoftimin elektronik të vlefshëm, për shtetasit mbi 16 vjeç.

3. Në mungesë të pasaportës së fundit shtetasi dorëzon një nga dokumentet e mëposhtme:

a) vetëdeklarimi i humbjes, vjedhjes, dëmtimit ose sekuestrimit, i cili kryhet *online* ose fizikisht pranë komisaritit përkatës të Policisë së Shtetit;

b) vërtetim mbi depozitimin e denoncimit në policinë e shtetit të huaj; gjatë aplikimit ky dokument duhet të dorëzohet i apostiluar, apo i legalizuar, i përkthyer dhe i noterizuar.

c) vërtetim mbi vetëdeklarimin e humbjes ose të dëmtimit të dokumenteve pranë misionëve diplomatike ose posteve konsullore.”.

2. Në nenin 5, pika 5, fjalia e parë riformulohet dhe ndryshon me këtë përmbajtje:

“5. Operatori i ngarkuar për kryerjen e aplikimit informon shtetasin mbi procedurën e aplikimit dhe vijon me dëmtimin fizik të pasaportës së vjetër, duke prerë bandën e MRZ-së.”

Neni 4

1. Në nenin 13, pikat 1, 2 dhe 3, riformulohen dhe ndryshojnë me këtë përmbajtje:

“1. Për aplikimet e kryera në zyrat e aplikimit të shoqërisë “IdentiTek” sh.a. ose kur aplikimi realizohet nëpërmjet dokumentacionit fizik në misionet diplomatike dhe postet konsullore, veprohet si më poshtë:

a) Formularët e aplikimit bashkë me dokumentacionin shoqërues, si: banda MRZ-së e pasaportës së mëparshme, vërtetimi i vetëdeklarimit të humbjes/dëmtimit ose denoncimit të vjedhjes në polici, që kanë shërbyer për aplikim, pasi administrohen fillimisht në



Zyrën e Aplikimit, dërgohen për arkivim në zyrën qendrore të shoqërisë.

2. Për aplikimet e kryera në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik në zyrat e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, veprohet si më poshtë:

a) në të gjitha rastet kur aplikimi për dokument identifikimi është kryer nëpërmjet nënshkrimit elektronik, në përputhje me kriteret e nenit 16 të ligji nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar, nuk procedohet me dërgimin me postë të dokumentacionit të aplikimit (fletë aplikimi, MRZ, dokumente identifikimi të kthyer nga shtetasit, raporte humbje, sekuestrimi etj.), në zyrën qendrore të shoqërisë.

b) brenda 60 ditëve nga data e aplikimit shoqëria informon zyrën e misionit diplomatik ose të postit konsullor mbi asgjësimin e dokumentacionit të aplikimit që nuk konsiderohet më i nevojshëm, ose mbi çdo kërkesë specifike për këto dokumente.

c) asgjësimi i dokumentacionit të cituar në pikën 2, shkronja “a” të këtij neni evidentohet shkresërisht nga përfaqësuesit e zyrës së misionit diplomatik ose postit konsullor.

3. Kopjet e formularëve të vetëdeklarimit me fotografi administrohen nga Policia e Shtetit dy vjet pas mbarimit të vlefshmërisë së pasaportës.”.

Neni 5

1. Në nenin 14, pika 2, në fund të fjalisë së parë, numri “... 18 ...” zëvendësohet me numrin “... 12 ...”.

Neni 6

Dispozita përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria “IdentiTek” sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

2. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme ose struktura të tjera të autorizuar nga ministri i Brendshëm.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

URDHËR

Nr. 200, datë 3.3.2025

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISËT E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe të tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Shijak;
- Njesisë Administrative Xhavzotaj;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Manzë;
- Njësive administrative të qytetit të Durrësit.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Shijak;
- Njesisë Administrative Xhavzotaj;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Manzë;
- Njësive administrative të qytetit të Durrësit.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influcencës Aviare”, vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj sëmundjes së influencës aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e:

- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Shijak;



- Njesisë Administrative Xhavzotaj;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Manzë;
- Njësive administrative të qytetit të Durrësit.

4. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të shpendëve të egër, veçanërisht ato të ujtit, si dhe monitorimin e mëtejshëm për zogj të ngordhur ose të sëmurë në territorin e:

- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Shijak;
- Njesisë Administrative Xhavzotaj;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Manzë;
- Njësive administrative të qytetit të Durrësit.

5. Ky urdhër zbatohet në përputhje me:

- Urdhrin nr. 117, datë 19.3.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë”;

- Urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, “Për miratimin e planit të kontigjencës për sëmundjen e influencës aviare”;

- Urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e programit kombëtar të mbikëqyrjes së influencës aviare”;

- Urdhrin nr. 235, datë 27.7.2009, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e biosigurisë ndaj gripit të shpendëve të shkaktuar nga nëntipi H5N1, në zogjtë e egër, në shpendët, pulat e stabilimenteve të shpendarisë’”;

- Urdhrin nr. 236, datë 27.7.2009, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi disa masa mbi mbrojtjen ndaj gripit të pulave, shkaktuar nga nëntipi H5N1 te zogjtë e egër’”.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM

Nr. 129, datë 6.3.2025

PËR MIRATIMIN E PLATFORMËS ELEKTRONIKE PËR PARAQITJEN E KËRKESAVE EDHE ONLINE TË ZGJEDHËSVE QË VOTOJNË NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika 8, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 10 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 61, pika “ë”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 36, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 23, datë 24.1.2024 “Për krijimin e ‘E-Mail Server’ për postën elektronike zyrtare të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimit nr. 354, datë 11.7.2024, “Për miratimin e rregullores ‘Për përdorimin e postës elektronike zyrtare në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Sistemin Gjyqësor’”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e platformës elektronike “Microsoft Exchange Server” për paraqitjen e kërkesave edhe online për zgjedhësit që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Kërkesat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të dërgohen në adresën zyrtare diaspora@gjykata.gov.al.

3. Gjykata shqyrton dhe vendos për kërkesat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, edhe nëpërmjet platformës elektronike “Microsoft Teams”, brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve.

4. Ngarkohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 432 lekë

